



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.199, datë 12.07.2022

PËR

**“NJËSIMIN E STATUSIT TË NDIHMËSIT LIGJOR ME KËSHILLTARIN
LIGJOR PRANË NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR NË PROKURORINË E
PËRGJITHSHME”**

Bazuar në nenin 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 165, pika 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 69 të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të deklaroj njësimin e statusit të ndihmësit ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme me këshilltarin ligjor jo-magjistrat në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme për zonjën Klerona Meçi.
2. Efektet financiare për njësimin e kategorisë së pagës fillojnë nga data 28.01.2022 dhe shtrijnë efektet deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit Klerona Meçi.
3. Të njoftohen për këtë vendim zonja Klerona Meçi dhe Prokurori i Përgjithshëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 12.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj



ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani